

RIDEFINIMI I ROLIT TË VIKTIMËS NË TË DREJTËN PENALE BASHKËKOHORE PËRMES REFORMAVE LIGJORE

Besa ARIFI*

Abstrakt:

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë zhvillimin e rolit të viktimës në të drejtën ndërkombëtare dhe atë ndërkombëtare penale duke filluar nga evoluimi i rolit të individit dhe të drejtave të tij nga Vestfalia 1648 deri në Luftën e Dytë Botërore për të vazhduar me kornizën normative të të drejtave të viktimës në periudhën bashkëkohore. Në këtë aspekt, do të analizohen dokumentet kryesore ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e viktimës. Si që do të konstatohet në punim, konventat dhe deklaratat themelore për të drejtat e njeriut promovojnë fare pak të drejta për viktimën. Me përjashtim të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore si dhe Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut, dokumentet tjera të kësaj natyre nuk flasin fare për të drejtën e individit të fitojë kompensim për dëmin që i është shkaktuar nga një vepër penale. Në anën tjetër, statutet e dy tribunalëve ndërkombëtare penale ad hoc (ai për ish-Jugosllavinë dhe për Ruandën) si dhe statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare promovojnë një numër të konsiderueshëm të të drejtave mjaft të rëndësishme për viktimat, duke kërkuar që parimet e gjykimit të drejtë të zbatohen “me respekt të plotë ndaj të drejtave të të akuzuarit por edhe në konsideratë me të drejtat e viktimës...”. Gjykata Ndërkombëtare Penale në veçanti promovon masa serioze për mbrojtje dinjitoze dhe kompensim të drejtë për viktimat, gjë që do të prezantohet në detaje në këtë punim.

Fjalët kyç: *E drejta restorative, viktimat, pjesëmarrja e viktimës, dëshmitari, mbrojtja e viktimës dhe dëshmitarit.*

* Qendra për të Drejtat e Njeriut, Fakulteti Juridik; Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni.